




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit		
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së	e	
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare Përgjithshme në MPL	e	Datë: 03.07.2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	e	Nr.020-209/6
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit		
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës		

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr. 12. 463-11623 për caktimin e qirasë joprofitabile për përfituesit e programit të veçantë të banimit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine
Ministry of Economy and Environment

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MUEJESIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Nr. Org. Org. Jednina Org. Unit 02-08
Nr. Prot. Prot. No. 2012-2/20
Nr. Hapësirë Broj. Prostora No. of spaces - 03 -
Data Datum Date 01.01.2020
Prishtinë / B

HYRJESE-ULAZNA-INTRODUCING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data Datum Date 02.07.2020
Ministria organizatorit Nr. i Llojit Shënimi Vlera
~VI-01-209/6

Për:	Goran Rakić, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Blerim Kuçi, Ministër i MEA Mentor Sylmeta, ud.Sekretar i Përgjithshëm i MEA
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Minister,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim por bazuar në ndryshimet dhe Vendimin e Qeverisë nr. prot 784 datë 05.06.2020 për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës ndryshon përberja edhe emërtimi Ministrisë tani në Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe akti i rikthyer me këtë shkresë përcjellëse riprocedohet si në vijim:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit
Ministarstvo Infrastrukture i Sredine
Ministry of Infrastructure and Environment

Për :	Emilija Rexhepi, Ministre në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Lumir Abdixhiku, Ministër i MIA Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i MIA
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor, <i>[Signature]</i> Data: <u>10</u> / <u>03</u> / 2020
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Sabriqe Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

E nderuar Ministre,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 05/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së

Infrastrukturës dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.12. 463-11623, për caktimin e qirasë joprofitabile për përfituesit e programit të veçantë të banimit, i miratuar në Kuvendin Komunës së Glllogocit

I miratuar me datë: 28.02.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 03.03.2020
--

I dërguar për shqyrtim në MIA, me datë: 06.03.2020
--

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.